

EMDR

Terapia e Desensibilizimit dhe Ripërpunimit të Lëvizjeve Okulare

Parimet bazë,protokollet dhe procedurat.

Francine Shapiro

Ky manual nuk do të ishte publikuar në gjuhën Shqipe pa suportin e Shoqatës EMDR EUROPE dhe EMDR ALBANIA dhe terapistët e Emdr Albania të cilat me shumë përkujdesje dhe profesionalizëm kanë përkthyer librin: Anisa Zaçe, Emiranda Jahja, Eralba Zenelaj, Imo Alikaj,Megi Kociaj, Melisa Ismaili dhe Paola Gjika.

Një vepër unike e shumëpritur prej disa vitesh në gjuhën Shqipe, Manuali i Francine Shapiro me vit zbulimi të efektshmërisë së desensibilizimit nëpërmjet lëvizjeve okulare që prej vitit 1987.Plot 568 faqe, të cilat shënojnë historinë e Terapisë EMDR, ku janë rreshtuar më shumë se 30 vite zbulime, hulumtime, raste klinike dhe udhëzime.

Intuita e Francine Shapiro dhe puna e saj e mundimshme eksperimentale, para se ta prezantonte këtë metodë para një audience ndërkombëtare profesionistësh, do të mbeten gjithmonë një pasuri e shkencës psikologjike. Ashtu si shumë nga zbulimet e mëdha shkencore, edhe EMDR-ja lindi rastësisht.Është një strategji e zhvilluar empirikisht, e cila më pas ka bërë të mundur ndërtimin e një qasjeje efektive për terapinë e traumës.

Ky manual ndër vite ka qënë baza e sigurt e mijëra terapistëve Emdr në mbarë globin, i përkthyer në dhjetra gjuhë, shërben jo vetëm për aplikimin korrekt të Protokollit Standart, por për të njohur më nga afër aftësitë e jashtëzakonshme të aplikeushmërisë në një panoramë klinike gjithmonë e më shumë në evolucion.

Në këto vite udhëzimet e Francine Shapiro-s për praktikën e mirë dhe ndërhyrjet humanitare që karakterizojnë Shoqatat kombëtare në pesë kontinentet, kanë qënë një guidë gjithmonë prezente në udhëtimin tonë, gjithashtu mijëra pacientë trajtohen terapeutikisht çdo ditë nga terapistët e Shqipërisë dhe Kosovës, të cilët supervizionohen dhe akreditohen me liçencat europiane sipas kriterëve të themeluara nga Francine Shapiro.

Do të keni mundësinë të lexoni sesi autorja ka dokumentuar hap pas hapi arritjen e të menduarit ndryshe për patologjinë dhe gjithashtu do të observoni sesi teoria ku bazohet Emdr dhe procedurat klinike janë testuar ndër vite gjërësisht me rezultate të qëndrueshme që tregojnë vlerën e tyre, mjafton të aplikohen protokollet në mënyrë rigoroze dhe efektet do të jenë shumë pozitive (Maxifield & Hyer, 2002).

Ky manual nëpërmjet ndjeshmërise së ekspozimit të rasteve klinike nga vetë autorja, do ju orientojë në zbulimin e shkaqeve të zhvillimit të sëmundjeve mendore si dhe duke vendosur fokusin te ngjarjet e jetës stresuese ose/dhe traumatike dhe si ato kanë impaktuar në moshën e zhvillimit dhe më vonë gjatë jetës.

Klinikistët që do ti afrohen Terapisë Emdr për herë të parë do të perceptojnë menjëherë sesa lehtësisht në këtë manual orientimet e ndryshme psikoterapeutike sinkronizohen me aplikimin e protokollit në të gjitha fazat e tij dhe sesa teoria ku bazohet qasja Emdr, modeli A.I.P (Adaptive Information Processing) orienton fiziologjikisht çdo ndërhyrje tek pacientët ku fokusi është elaborimi i ngjarjeve traumatike.